



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1087/2 prot.

Tiranë, më 03.08.2021

### V E N D I M

**Nr. 139, datë 03. 08. 2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr. 132, datë 22.07.2021, e shtetasit Sh. K., kundër Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë Tiranë (në vijim KMCAP), me pretendim diskriminimin për shkak të “gjendjes shëndetësore”<sup>1</sup> dhe “çdo shkak tjetër”<sup>2</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I :

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, në mes të tjerash, subjekti ankues deklaroi se vuan nga “Hernia diskale” dhe për këtë shkak, më datë 04.10.2018, i është nënshtuar një ndërhyrje kirurgjikale. Në këto kushte dhe mbështetur në Fletë Drejtimin për KMCAP të lëshuar nga Shërbimi i Neurokirurgjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, ankuesi është drejtuar në KMCAP-në e Drejtorisë Rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për t’u komisionuar.

Pas konsultimit të rastit, nga ana e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, me Vendim Nr. 327, datë 12.03.2019, është caktuar se ankuesi nuk i plotëson kushtet për të fituar të ardhura për invaliditet.

Përsa më sipër, ankuesi ka ankimuar vendimin e sipërcituar, në KMCAP Epror të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Nëpërmjet përgjigjes, ankuesi është vënë në dijeni të Vendimit Nr. 213, datë 21.05.2019, me anë të të cilit është konstatuar sërish se nuk plotëson kushtet për të fituar të ardhura për invaliditet.

<sup>1</sup> Referuar Fletë Drejtimit për KMCAP Nr. E010298 rregj., datë 05.10.2018, ankuesi vuan nga Hernie Diskale.

<sup>2</sup> Sa i përket këtij shkak, ankuesi nuk ka paraqitur pranë Komisionerit asnjë karakteristikë apo veçanti që mbart dhe që prezumohet që ka ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese të pretenduar.

Në vijim, ankuesi pretendon se nga ana e KMCAP Epror është sqaruar se duhet t'i drejtohet KMCAP për personat me aftësi të kufizuara në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë. Në këto kushte, ankuesi ka përgatitur dokumentacionin përkatës dhe i është drejtuar KMCAP-së së Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, i cili me Vendimin Nr. 3648, datë 16.07.2019, ka konstatuar të njëjtin përfundim si KMCAP Epror i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Gjatë vitit 2020, ankuesi pretendon se gjendja shëndetësore e tij është përkeqësuar dhe më datë 23.05.2020 ka kryer vizita mjekësore pranë Shërbimit të Neurologjisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë. Më datë 17.09.2020, nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, ka marrë sërish Fletë Drejtimi për në KMCAP.

Përsa më sipër, ankuesi i është drejtuar fillimisht Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, e më pas atij Epror të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të cilët kanë vendosur sërish se ankuesi nuk i plotëson kushtet për të fituar të ardhura për invaliditet.

Në këto kushte, ankuesi pretendon se është diskriminuar nga ana e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë për shkak të gjendjes shëndetësore dhe çdo shkak tjetër. Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e situatës diskriminuese dhe ndërmjetësimin me KMCAP Tiranë, për përfitimin e të ardhurave nga invaliditeti.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, konstatohet se:

- KMCAP i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me Vendim Nr. 327, datë 12.03.2019, ka vendosur që ankuesi nuk përfiton pagesën e aftësisë së kufizuar. Kundër vendimit të KMCAP-it, personi ka të drejtë të ankohet brenda 30 ditëve. Ankesa bëhet me shkrim dhe dorëzohet pranë DRSSH-së përkatëse.
- Ankuesi pas marrjes së vendimit të sipërcituar, ka paraqitur ankim pranë KMCAP Epror në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, i cili me Vendim Nr. 213, datë 21.05.2019 ka vendosur që ankuesi nuk përfiton pagesën e aftësisë së kufizuar.
- Në vijim ankuesi i është drejtuar KMCAP-së së Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, i cili me Vendimin Nr. 3648, datë 16.07.2019, ka konstatuar që ankuesi nuk përfiton pagesën e aftësisë së kufizuar.
- Vendimin e sipërcituar ankuesi nuk rezulton ta ketë ankimuar në KMCAP Epror të Shërbimit Social Shtetëror.
- Në vitin 2021, KMCAP Epror i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ka vendosur sërish që ankuesi nuk përfiton pagesën e aftësisë së kufizuar, me Vendimin Nr. 153, datë 24.06.2021.

Lidhur me pretendimet e subjektit ankues, për kundërshtimin dhe mosdakordësinë e tij me vendimin e fundit të KMCAP Epror, Komisioneri informon subjektin ankues, se vendimi i këtij Komisioni kundërshtohet gjyqësisht, pasi Gjykata jep vendimin përfundimtar lidhur me këtë çështje. Rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtij organi nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në nenin 8/c) të ligjit nr. 57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se, një ndër kategoritë përfituese të pagesës për aftësinë e kufizuar janë: “c) personat me aftësi të kufizuar, të deklaruar të tillë me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar”.

Neni 29 i këtij Ligji dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, shprehen në mënyrë të detajuar për procedurën e ankimit, në rastet kur aplikuesit/përfituesit nuk janë dakord me vendimmarrjet e komisioneve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se: “1. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë dhe personi me aftësi të kufizuar, kur gjykon se i është shkelur një e drejtë e garantuar nga ky ligj, mund të paraqesin ankesë me shkrim pranë bashkisë/njësisë administrative brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit. Struktura vendore shqyrton ankesën dhe njofton me shkrim ankuesin brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

2. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga struktura vendore, pas ezaurimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Struktura rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, njofton me shkrim të interesuarin dhe njësinë e vetëqeverisjes vendore brenda 14 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

4. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuar, që pretendojnë se u është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzojnë të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Pika 3, e Vendimit nr. 182, datë 26.02.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal” parashikon se: “Vlerësimi i gjendjes mjekësore të personave të përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu, bëhet nga komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë (KMCAP) të nivelit të parë, të Shërbimit Social Shtetëror.” Në pikën II/1, të këtij Vendimi përcaktohet se: “Pranë Shërbimit Social Shtetëror do të ngrihen dhe do të funksionojnë 5 (pesë) KMCAP-e të nivelit të parë, që do të vlerësojnë në nivel kombëtar dosjet e personave të përcaktuar në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, me këtë përbërje: ..... c) 1 (një) KMCAP për paraplegjinë, tetraplegjinë dhe neurologjinë, që do të ketë në përbërje neurolog; .....”.

Referuar pikës 13, të VKM-së së sipërcituar rezulton se vendimi i KMCAP-së eprore të specializuar nuk mund të ndryshohet nga KMCAP-ja e nivelit të parë. Në ato raste kur KMCAP-ja e nivelit të parë gjykon se kërkuesi paraqet gjendje shëndetësore të rënduar dhe bën objekt për

të ndryshuar kushtet e përfitimit, ai merr vendim duke argumentuar edhe arsyen e këtij ndryshimi. Në këto raste, pavarësisht vendimit të KMCAP-së së nivelit të parë, vendimi do të hyjë në fuqi vetëm pas miratimit të KMCAP-së eprorë të specializuar. Sipas aktit nënligjor të sipërcituar, vendimi i KMCAP Epror është i formës së prerë.

Aplikuesi ka të drejtën e ankimimit për procedurën e vlerësimit edhe në rastet kur ai pretendon për nivelin e përfitimit të pagesës mujore për shkak të aftësisë së kufizuar. Në rastet e ankimimit të vendimit të KMCAP-it për përfitimin të aftësisë së kufizuar, Komisioni i nivelit më të lartë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, KMCAP Epror, vlerëson nëse ankimi është i pranueshëm dhe i bazuar, dhe vendos përfundimisht me anë të një vendimi i cili në vetvete përbën një akt administrativ.

Në ankesën e bërë pranë KMD-së, Sh. K. ka kërkuar që të rivlerësohet nga KMCAP-të përkatëse dhe të përfitojë të ardhura nga invaliditeti, vlerësim i cili mund bëhet vetëm nga komisionet e specializuara për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Përgjigja e argumentuar, pra vendimi i arsyetuar që marrin këto komisione, bazohet në intervistat e zhvilluara dhe lidhet kryesisht me vlerësimin dhe caktimin e diagnozës mjekësore.

Për shkak të natyrës specifike apo natyrës juridike të marrëdhënies që krijohet gjatë vlerësimit të aftësive për punë, këto vendime mund të merren vetëm nga mjekët e specializuar pranë KMCAP-ve Rajonale dhe Eprorë.

KMCAP-të Rajonale dhe Eprorë janë ekipe të përzgjedhur, të përbërë nga mjekë dhe punonjës social, të cilët janë të punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, si dhe janë përgjegjës për kryerjen e vlerësimit bio-psiko-social të aplikuesve për përfitimet në para dhe/ose në natyrë për shkak të aftësisë së kufizuar, bazuar në dokumentet e përgatitura nga institucionet shëndetësore, informacionin e marrë nga intervistat e zhvilluara, verifikimin dhe shkëmbimin e informacionit me institucione të tjera sociale, arsimore, shëndetësore, të punësimit e formimit profesional.

Çdo person i interesuar, i cili pretendon se i është shkelur, mohuar apo cënuar një e drejtë e ligjshme nga një organ i administratës publike, në rastin konkret, KMCAP-të Rajonale dhe Eprorë, krahas ushtrimit të së drejtës së ankimit administrativ, mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij edhe me anë të një mjeti tjetër ligjor, që është padia e cila ngrihet përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Si rregull, padia paraqitet pasi është ndjekur më parë rruga administrative.

Neni 42 i Kushtetutës vendos standarde kushtetuese si për gjykatat, ashtu dhe për organet e administratës publike. Pika 2 e po këtij neni, sanksionon se kushdo mund t'i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. Kjo dispozitë, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cënim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar dhe rastin kur cënimi vjen dhe nga një akt administrativ i tillë.

Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 39/1 “Ankimimi në Komisionin Epror”, në pikën të 3 të tij, ka përcaktuar se: “Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë”.

Bazuar në sa më lart, Komisioneri sqaron se, rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtyre organeve (KMCAP Rajonale dhe atyre Epror) nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10 21/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar në ligjin 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, dhe në ligjin nr. 57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, t’i drejtoheni Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për të kundërshtuar vendimin e fundit të KMCAP Epror të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon gjithashtu subjektit ankues, që për problematikën e tij, t’i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike<sup>4</sup>, ose Shërbimit Ligjor Falas<sup>5</sup>.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit Sh. K., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

---

<sup>3</sup> Për analogji citojmë: Vendimin nr.185, datë 28.09.2018, Vendimin nr.55, datë 24.04.2019, Vendimin nr.06, datë 08.01.2020, Vendimin nr. 61, datë 12.06.2020, Vendimin nr. 59, datë 13.04.2021, dhe Vendimin nr. 78, datë 07.05.2021 të KMD, publikuar në web-in e institucionit: [www.kmd.al](http://www.kmd.al).

<sup>4</sup> Me adresë: Pranë Ministrisë së Drejtësisë, Blv. “Zogu i Parë”, Tiranë.

<sup>5</sup> Me adresë: Bulevardi: “Bajram Curri”, Pall: “Agimi”, Shk. 18, Ap. 322, Tiranë, Nr.tel: 0422 53113.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Gjendja shëndetësore dhe çdo shkak tjetër)  
(Fusha: Të mira dhe shërbime)